



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
MK-76
Prishtinë, më 28 korrik 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 28 KORRIK 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Slllobodan Petroviq dhe Myfera Shinik, kurse mungoi Sabri Hamiti.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Naim Abazi, dhe Sherif Konjufca.

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 korrik 2009,
2. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave,
3. Të ndryshme.

1. Miratimi Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 korrik 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 korrik 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave

2.1 Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, vendosi që atë ta radhisë për shqyrtim në seancën e parë plenare të sesionit vjeshtor.

2.2 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me rekomandimet për kërkesën e shoqërisë civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale

Kryesia përkrahu rekomandimin e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media dhe përfundimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me kërkesën e shoqërisë civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale, me të cilat e ka njoftuar propozuesin, përkatësisht organizatat e shoqërisë civile.

2.3 Njoftimi me shkresën e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë lidhur me përfundimin e mandatit të tre anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale

Kryesia u njoftua me shkresën e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë lidhur me përfundimin e mandatit të tre anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale. Kryesia dy herë radhazi ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të ndërmarrë veprime të nevojshme për propozimin e anëtarëve të Bordit të Komisionit për Miniera dhe Minerale, por ende nuk ka marrë përgjigje për këtë.

2.4 Njoftim me Raportin e tre deputetëve pjesëmarrës në Asamblenë X Parlamentare të NATO-s

Kryesia u njoftua me Raportin e tre deputetëve pjesëmarrës në Asamblenë X Parlamentare të NATO-s

2.5 Shqyrtimi i Propozim-Rregullore për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Propozim-Rregulloren për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Kosovës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohet Administrata e Kuvendit - Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale, që vërejtjet dhe propozimet e Kryesisë së Kuvendit, që janë të regjistruara në transkript, t'i inkorporojnë në tekstin përfundimtar të Projekt-Rregullore për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit.
2. Teksti i spastruar i Propozim-Rregullore për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit, pasi të shqyrtohet nga ana e dy anëtarëve të Kryesisë, të ngarkuar për Administratën e Kuvendit, duhet t'i paraqitet Kryesisë së Kuvendit për miratim në mbledhjen e parë të muajit shtator 2009.
3. Ngarkohet Shërbimi i Personelit të Administratës që për çdo pozicion veç e veç, t'i përshkruajë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit zyrtar të Administratës së Kuvendit.

3. Të ndryshme

3.1 Shqyrtimi i propozimit lidhur me shpalljen e konkursit për pranimin e zyrtarëve në Divizionin për Media dhe Marrëdhënie me Publikun

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e cekur me lart, mori këtë

V E N D I M

1. Të shpallet konkurs për pranimin e katër (4) zyrtarëve në Divizionin për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, sipas përshkrimit të specifikuar të detyrave në Organogram.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që të ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale për shpalljen e konkursit, të cekur në paragrafin një (1) të këtij vendimi.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**